



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**MINISTRIA E BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
QËNDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORË**

PROJEKT: KËRKIM NË FERMË

RAPORT – PËRFUNDIMTAR

Titulli i projektit:

“Monitorimi dhe luftimi i mizës mesdhetare në agrume”

Afati i zbatimit viti 2013:

Drejtues projekti
Mendim Baçaj
Athina Llambro

TITULLARI
Dr Aulona Veizi

Hyrje

Miza mesdhetare e agrumeve përbën padyshim një nga dëmtuesit kyç të pemëve frutore dhe agrumeve në vëndin tonë por edhe në botë. Për herë të parë është çfaqur në vitin 1965 në Kamëz-Tiranë dhe mendohet të ketë ardhur nga Italia. Prek rreth 260 kultura të ndryshme bujqësore duke shkaktuar dëme të konsiderushme të prodhimit. Deri në fund të verës ajo atakon kryesisht kokrrat e pemëve frutore, ndërsa në vjeshtë prek agrumet. Frutat e agrumeve të prekura çfaqin në lëkurë njolla me ngjyrë jeshile të errët, të cilat me kalimin e kohës zbuten dhe janë pak të shtypura. Më tej larvat fillojnë të ushqehen me tulin e frutit duke shkaktuar kalbjen dhe rrëzimin para kohe të tyre. Larva shkakton ulje të cilësive organoleptike dhe zvogëlim të tullit të frutit, e cila krijon shumë problem (kalbëzim) në frutat me madhësi të vogël. (mandarinat)

- Nxit rënien e parakohshme të frutave për shkak të infeksioneve shkaktuar nga metabolizmi sekondar i larvave.

- Edhe pse nuk arrihet dëmtim i plotë i frutit, fakti që në frut ka dëmtim, ka humbje vlerash tregëtare dhe mund të shkaktojë rënie të shitjes në treg të prodhimit.

Çdo dëmtim i tillë shkakton një përkeqësim në cilësinë e frutave, si dhe një kërcënim real për eksport dhe marketing, prandaj, marrja e masave në kohë për luftimin i këtij dëmtuesi është i detyruar dhe shumë efikas.

Në vartësi të kushteve klimatike të zonës ka 3-16 brezni në vit. Pragu më i ulët i temperaturës për zhvillim është 13.5 ° C. Ndërsa ai normal është 22°-25°C. parametra këto që sigurohen në kushtet e vëndit tonë. Një femër pjell deri në 10 vezë në ditë ndërsa gjatë jetës së saj pjell deri në 800 vezë në kushte të përshtatëshme zhvillimi.

Personi përgjegjës - Nga Q.T.T.B.-ja: Mendim Baçaj, Athina Llambro, Lumturi Xhelilaj.

Personi përgjegjës nga D.R.B.U.M.K. Vlorë :Dashmir Peçi- Sarandë

Studimi u krye në fermën ku kultivohen agrume (mandarina) me moshë mbi 5 vjet në cv. Klementina në terren fushor me fermer z. Kostandin Koço.

Objektivi i kërkimit.

Përcaktimi afatit të ndërhyrjes dhe teknikave optimale që përdoren në kontrollin e mizës mesdhetare të agrumeve.

Metodat dhe materialet e përdorura

Përshkrimi i metodologjisë së kërkimit: (metoda e kampinimit: numri i fermerëve pjesmarrës dhe kriteret e seleksionimit, skema e eksperimentit, shkurtimisht).

Studimi u ngrit në fshatin Mursi të komunës Xarë (Sarandë) në mandarina Klementina, me moshë në prodhim të plotë, në një fermë me pronar z Kostandin Koço.

Studimi u ngrit në dy prova:

P.1-Trajtime me preparatin Spinosad cdo 21 ditë pas kapjes së fluturave te para.

P.2- Trajtime me preparatin Lanat 20 SL (methomyl 20%) me dozën 0.2-0.3% në intervale kohore 15-20 ditë nga njëra tjetra.

Për të bërë monitorimin e mizës mesdhetare të agrumeve u aplikua metoda e kapjes me kurthe specifike të shoqëruara me ferromonet përkatëse të këtij dëmtuesi. Këto kurthe u varën në pemë (mandarina) gjatë muajit Gusht. U vendosën gjithsej 6 kurthe dhe u kontrolluan një herë në javë për numërin e mizave të rëna. Të dhënat e marra u shënuan në fletore nga ku u gjykua për të përcaktuar momentin e ndërhyrjes me trajtimet kimike. Një javë pas kapjes të mizave të para u dha sinjali për fillimin e trajtimeve kimike.

Provat u ngritën në agrume me moshë 5-10 vjeçare të tipit intensiv me distancë mbjellje 5 m X 6 m me dendësi 330 bimë/ha me tre variante.

1. Numuri i mizave të rëna për cdo kurth (kurthet vendosen nga mesi i muajt Maj)
2. Përqindja e kokrrave të prekura për cdo provë
3. Numri i trajtimeve kimike me pesticide për çdo provë
4. Efektiviteti ekonomik

Kërkimi është i tipit “Provë” i ngritur në 2 variante.

Në fermat që ndodhen në Komunën Xarë fshati Mursi, toka është L.H.K. me përbërje S.A.M, terren fushor. Lartësia mbi nivelin e detit deri në 100 m. Mandarinat janë mbjellë nga fermeri Kostandin Koço në vitin 2004 në terren fushor në distanca 6x5 metra.


Nga përbërja agropedologjike këto toka rezultojnë të pasura, të thella, L H K me përmbajtje të lartë të fosforit dhe potasit.




Monitorimi i mizës mesdhetare të agrumeve (20 Korrik 2013).

Rezultatet


Te dhena per monitorimin e demtuesit dhe sperkatjet				
Mursi-sarande 2013				
data	Kurthet monitorimit			Sperkatjet
	1	2	3	
				Spinosat
20 Korrik	0	0	0	
27 korrik	0	0	0	
03 korrik	0	0	0	
10 Gusht	1	0	0	spinosat
17 Gusht	0	1	1	
24 Gusht	1	2	1	
31 gusht	0	0	1	Spinosat
07 Shtator	1	2	1	
14 Shtator	2	1	2	
21 Shtator	2	1	0	Spinosat
28 shtator	1	2	1	
04 tetor	1	0	3	
11 tetor	2	2	1	Spinosat
18 tetor	2	3	1	
25 tetor	3	2	2	
30 tetor	2	2	3	Spinosat
07 nentor	3	3	2	
14 nentor	3	1	2	



Analiza e infeksionit ne kokerr nga miza mesdhetare e agrumeve 2013				
Data	% e infeksionit aktiv në kokërr nga miza mesdhetare			
	deshmuesi	Spinosat		Lanat
20 shtator	0	0		0
30 shtator	0	0		0
10 tetor	0	0		0
20 tetor	1	0		0
30 tetor	5	0		0
10 nentor	8	1		0
17 nentor	8	2		1



Efektiviteti ekonomik i studimit , per 34 bime/prove ne 0.1 ha.					
Emertimi	prodhimi ne kg.	Cmimi ne leke	E ardhura ne leke	Shpenzim ne leke	Fitimi ne leke
Deshmus	720	50	36000	8600	27400
Spinosat	850	50	42500	9380	33120
Lanat	986	50	49300	9520	39780



Vlerësimi i rezultateve

1. Nisur nga të dhënat e mësipërme rezultojn se fluturat e para të mizës mesdhetare të agrumeve janë kapur qysh në dhjetë ditë të parë të muajit Gusht dhe menjëherë është organizuar puna për trajtimin e parë me preparatin Spinosad (1 metër katror në kurorë nga ana e lindjes). Këto trajtime kanë vazhduar deri në 30 tetor duke realizuar gjithsej 5 spërkatje. Ndërsa analiza e infeksionit aktiv në kokërr rezultoi se mbas datës 20 tetor u kapën larvat e para, analizë kjo e cila shërbeu si sinjal i fillimit të spërkatjes në të gjithë kurorën me preparatin Lanat 0.2% (methomyl).

2. Mbështetur në treguesit e prodhimit u vërejt se ndryshimet midis dy provave për njësi të sipërfaqes dhe numrit të bimëve nuk është shumë i madh me ndryshime të vogla midis tyre. Prodhimi ka qënë më i lartë në provën me Lanat dhe më i ulët në 0,1 ha ku nuk janë përdorur dy preparatet e mësipërme. Në aspektin e sigurisë ushqimore dhe në atë të ruajtjes së biodiversitetit (faunës së dobishme), prova ku është përdorur Spinosadi, padyshim qëka epërsi të padiskutueshme ndaj provës me Lanat, pasi në këtë të dytën ky preparat krahas mbrojtjes më të mirë që realizon ndaj mizës, shkatërron parazitët biologjik dhe lë shumë mbetje në frut duke ulur ndjeshëm cilësinë e vet frutit përsa i përket sigurisë ushqimore.

Vlerësimi ekonomik

Tregues për efektivitetin ekonomik të provës.

Komuna Xare- Sarande

Nëpërmjet analizës së kostos së prodhimit për çdo t janë evidentuar të gjitha shpenzimet vjetore të kryera të përmbledhura në bazë materiale dhe shpenzime pune. Vlera e materialeve është llogaritur mbi mesataren e çmimit që blihen në tregun me pakicë, ndërsa për punën e krahut është parashikuar vlera mesatare e ditës së punës. Bazuar në këto të dhëna është përlllogaritur e ardhura neto, e cila ka dalë nga të ardhurat e realizuara minus shpenzimet e kryera. Nga kjo analizë konstatojmë se në proven me Lanat dhe pse janë realizuar më shumë shpenzime e ardhura neto është më e lartë, si rezultat i prodhimit dhe të ardhurave më të mëdha të realizuara në krahasim me provat e tjera

Diskutime dhe konkluzione

Bazuar në rezultatet e vitit të parë të cilat nuk janë të mjaftueshme për kohën prej një viti të ndjekjes së kësaj prove studimi (minimumi duhet të ishte 2-3 vjet) për një argumentim më të plotë nxjerrim disa përfundime bazuar këto dhe në eksperiencën shumë vjeçare që ka Q.T.T.B-ja në këtë fushë.

- Për një bllok mandarinash efektive me retabilitet ekonomik pozitiv duhet zbatuar tërësisht karta teknologjike e mirërritjes.

Monitorimi i mizës mesdhetare të agrumeve përbën një moment kyç dhe shumë të rëndësishëm në zinxhirin e zbatimit të agroteknikës, pasi fermeri përcakton më së miri momentin e ndërhyrjeve kimike për kontrollin e këtij dëmtuesi të rrezikshëm të agrumeve

Përdorimi i preparateve si Spinosadi sapo të kapen mizat e para në monitorim, ul ndjeshëm dinamikën e popullatës dhe ofron siguri të plotë përse i përket mbetjeve të ndryshme në frutat e agrumeve, në kundërshtim të plotë me preparatet e tjera të cilët kontrollojnë më mirë infeksionin por lënë pasoja në faunën e dobishme dhe në vetë frutin e agrumeve.

Mesazhet e ekstensionistit

1. Zbatimi me rigorozitet i agroteknikës në blloqet e mbjella me agrume përbën themelin e suksesit të çdo fermeri.
2. Agrumet preken nga një numër i madh sëmindjesh dhe dëmtuesish të cilët kërkojnë të monitorohen në kohë për të përcaktuar momentin me efikas të ndërhyrjeve kimike.
3. Futja në praktikën e mbrojtjes të bimëve të eshkave proteinike+insekticid biologjik duke trajtuar 1-2 metër katror nga ana lindore e kuroreës, përbën një metodë efikase në kontrollin e mizës mesdhetare të agrumeve sepse jo vetëm që ul koston e spërkatjeve por mbron edhe faunën e dobishme (parazitët biologjike).
4. Për të përcaktuar momentin e ndërhyrjeve kimike për kontrollin larvicid, është e

nevojeshme që çdo fermer me ndihmën e specialistit përkatës të bëjë analizën e infeksionit aktiv në kokërr dhe të marrë masa të menjëherëshme për fillimin e spërkatjeve me preparate të ndryshme që kontrollojnë mirë këtë dëmtues.

5. Në kultivarin e mandarinave Klementina të cilat piqen herët në vjeshtë është e domosdoshme qëaktivitetet e mësipërme si: monitorimet dhe ndërhyrjet me preparate kimike të fillojnë më shpejt në krahasim me kultivarët e tjerë që piqen më vonë, ku futet edhe portokalli, limoni etj.

REALIZIMI I BUXHETIT TË PROJEKTIT PËR PERIUDHËN Janar-Dhjetor 2013

Realizimi i BUXHETIT – (I detajuar sipas zërave të 602)

Shprehur në 000/lekë.

Nr. i artikulli	Emertimi i Artikullit	Plan vjetor 000/lek	Fakti	Diferenca
	Kurthe për monitorimin e mizës mësdhetare të frutave	10	1	x
	Pesticide për spërkatje	6	6	x
602 01	Shërbime udhëtimi	25	25	
602 04	Kanceleri	4	4	x
	Gaz	5	5	x
Totali		50	41	9

Studimi u realizua në bashkëpunim të plotë me ekipin e projektit specialist të fushës së bujqësisë (agronom+ekonomist) nga Q.T.T.B-ja Vlorë dhe ekstensionistin dhe fermerin e fshatit Mursi, komuna Zare Sarande.

Duhet theksuar se bashkëpunimi ka qënë i mirë. Ekstensionisti e shërbimit këshillimorë u përfshi në të gjitha aktivitetet e planifikuara duke dhënë ndihmesën e tij në momentet e veçanta të zbatimit të kerkimit ne ferme. Për vitin e ardhshëm me shërbimin ekstensionist të kësaj drejtorie do të zhvillohen demonstrime mbështetur në rezultatet e arritura nga studimi i kryer në vitin 2013.

Raporti përfundimtar pasi u përgatit nga drejtuesi i projektit në bashkëpunim me aktorët e tjerë, u firmos nga shefat e shërbimit të këshillimit të drejtorise rajonale të bujqësisë.

Raporti shoqërohet me fletë palosje e cila do t'u vihet në dispozicion fermerëve në momentin e demonstrimit të studimit dhe atyre që janë të interesuar të zbatojnë këshillat e mësipërme.

Drejtues i projektit
Mendim Baçaj
Athina Llambro
Lumturi Xhelilaj

Shefi i financës
Luljeta Malaj

TITULLARI

Dr Aulona Veizi

